Subjekti: Bashkohuni me NYCPS-në në një Takim të Hapur me Ofruesit e Shërbimit të Autobusëve

Të dashura familje të Shkollave Publike të NYC,

Zyra e Transportit të Nxënësve e Shkollave Publike të Qytetit të Nju-Jorkut ju fton përzemërsisht të merrni pjesë në takimin tonë të ardhshëm të hapur me ofruesit e shërbimit të transportit me autobus, të martën, më 1 dhjetor 2026, në orën 18:00, në **Queens Innovation Center, 53-16 Northern Boulevard, Woodside, NY 11377.**

Transporti i përditshëm i fëmijës suaj është një pjesë e rëndësishme e përvojës së tij shkollore. Ky takim i hapur ju ofron një mundësi të vlefshme për të bashkëbiseduar drejtpërdrejt me ofruesit e shërbimit, për të bërë pyetje, për të dhënë mendime dhe për të shprehur shqetësime lidhur me shërbimet e transportit të nxënësve.

Takimi do të përbëhet nga dy pjesë:

- Pjesa 1: Zyra e Transportit të Nxënësve (OPT) do të japë informacione të përditësuara dhe do t'u përgjigjet pyetjeve dhe çështjeve të përbashkëta të parashtruara paraprakisht nga familjet.
- Pjesa 2: Familjet që do të marrin pjesë fizikisht do të kenë mundësinë të flasin drejtpërdrejt me përfaqësuesit e ofruesit të tyre të shërbimit të transportit me autobus për shqetësime individuale ose çështje që lidhen posaçërisht me fëmijën e tyre.

Familjet mund të marrin pjesë fizikisht ose në distancë. Një lidhje për transmetimin e drejtpërdrejtë do të jetë e disponueshme në faqen e internetit të takimit të hapur me ofruesit e shërbimit të transportit me autobus (https://www.schools.nyc.gov/school-life/transportation/transportation-overview/whats-new/bus-vendor-town-hall).

Për të na ndihmuar në planifikimin e aktivitetit, i nxitim familjet të regjistrohen paraprakisht. Për t'u regjistruar, për të dërguar një pyetje ose koment dhe për të mësuar më shumë rreth aktivitetit, ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të takimit të hapur me ofruesit e shërbimit të transportit me autobus (https://www.schools.nyc.gov/school-life/transportation/transportation-overview/whats-new/bus-vendor-town-hall).

E kuptojmë rëndësinë e transportit të besueshëm për nxënësit dhe i vlerësojmë pikëpamjet e familjeve të cilave u shërbejmë. Ju nxitim të merrni pjesë për të dhënë mendime, për të bërë pyetje dhe për të bashkëbiseduar drejtpërdrejt me ofruesit e shërbimit të transportit. Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj në mbështetje të transportit të sigurt dhe të besueshëm për nxënësit e Shkollave Publike të Qytetit të Nju-Jorkut.

Në pritje për të pasur lajme prej jush.

Me respekt,

Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut